



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

**LEGJISLATURA VI**  
***Sesioni vjeshtor***

**Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor**

Mbledhja nr. 32

Prishtinë, më 11.12.2018, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

**PROCESVERBAL**

Në mbledhje morën pjesë: Muharrem Nitaj, Besa Gaxherri, Lutfi Zharku, Ganimete Musliu, Andin Hoti, Salih Zyba, Salih Salihu, Etem Arifi dhe Danush Ademi.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sërgjan Mitroviq.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Muharrem Nitaj**, kryetar i Komisionit.

***Rendi i ditës***

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të komisionit nga mbledhja e mbajtur më 27.11.2018;**
- 3. Agjenda e projektligjeve në komision;**
- 4. Të ndryshme.**

*Kryetari, pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.*

**1. Miratimi i rendit të ditës**

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

**2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, nga mbledhja e mbajtur më 27.11.2018;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, konstatoi se me 8 vota për, u miratua procesverbalit i mbledhjes së mbajtur më 27.11.2018.

**3. Agjenda e projektligjeve në komision;**

**Muharrem Nitaj**, kryetar, njoftoi se në Komision, në procedurë janë 6 projektligje, 2 prej tyre kanë kaluar leximin e parë : *Projektligji nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.*

05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit dhe Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, kurse janë 4 projektligje në pritje për votim të parë në seancë; Projektligji për mbrojtjen nga zhurma; Projektligji për krijimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit hapësinor në Republikën e Kosovës; Projektligji për produktet biocide; Projektligji për Odën e Arkitektëve dhe Odën e Inxhinierëve në fushën e ndërtimit.

Për **Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit**, kryetari **Nitaj** fjalën ia dha deputetes Besa Gaxherri, kryesuese e grupit të punës për hartimin e projektligjit.

**Besa Gaxherri**, tha se për këtë projektligj është propozuar 1 amendament nga Grupi parlamentar 6+, për paragrafin 2 të nenit 4., që ka të bëjë me lirimin nga pagesa për objektet e kultit dhe kërkoi mendimin e anëtarëve, nëse janë që të mbahet edhe një grup punues apo të shqyrtohet ky amendament në këtë mbledhje. Pasi që u dakorduan që të shqyrtohet në këtë mbledhje, ajo në vazhdim i lexoi tri variante të rregullimit të kësaj çështjeje:

Sipas ligjit në fuqi për rregullimin e shërbimeve të ujit, *“Objektet e kultit lirohen nga pagesa për shërbimet e ujit, në këtë lirim nuk përfshihen objektet përcjellëse administrative dhe fitimprurëse.”* Sipas projektligjit që është punuar nga komisioni bashkë me Autoritetin Rregullator të shërbimeve të ujit: *“Objektet e kultit dhe objektet përcjellëse administrative, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse, faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-industrialë.”* Ndërsa amendamenti i propozuar nga GP 6+ është: *“Objektet përcjellëse administrative, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-industrialë.”*

Ajo tha se varianti i ligjit aktual është korrekt, për arsye se rregullatori i ujit mund të kategorizojë faturimin vet, po ashtu, e arsyetoi propozimin në projektligj që të faturohet uji edhe në objektet e kultit, pasi që ka shpenzim të panevojshëm të ujit në këto objekte, ndërsa po të faturohej do të ruhej më mirë dhe kërkoi të shqyrtohen këto opsione.

**Muharrem Nitaj**, tha se objektet përcjellëse të institucioneve publike, në këtë rast objektet e kultit, zakonisht faturohen si biznese e jo familjare dhe pyeti nëse duhet të bëhet ky përjashtim siç është propozuar me amendament, pasi që objektet e kultit kanë shumë objekte përcjellëse dhe shtoi se në ligjin në fuqi është mirë e definuar kjo çështje.

**Danush Ademi**, e përkrahu amendamentin e GP 6+ dhe tha se objektet e kultit duhet të lirohen nga pagesa, ndërsa objektet përcjellëse administrative dhe fitimprurëse duhet të paguajnë.

**Salih Zyba**, tha se uji për pije në objektet e kultit ndoshta ja vlen me qenë pa pagesë, por duhet pasur kujdes të qëllimi i përdorimit të këtij uji, sepse mund të jetë objekt i kultit dhe të shfrytëzohet për ujitjen e gjelbërimit, ndërsa taksimi për objektet përcjellëse mvaret nga verprimtaria që ato zhvillojnë.

**Andin Hoti**, propozoi këtë variant *“Objektet e kultit dhe objektet përcjellëse administrative, të cilat nuk kanë objekte fitimprurëse, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa ato që kanë objektet përcjellëse fitimprurëse, faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë.”*

**Salih Salihu**, propozoi variantin : *“Objektet e kultit lirohen nga pagesa për shërbimet e ujit, ndërsa objektet përcjellëse administrative, faturohen në kategorinë e konsumatorëve shtëpiakë, ndërsa objektet përcjellëse fitimprurëse, faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-industrialë.”*

Pas diskutimeve, u dakorduan për një kompromis të propozimeve të ndryshme dhe të përkrahur nga Danush Ademi, përfaqësues i GP 6+ dhe **Besa Gaxherri**, e lexoi propozimin e amendamentit: *“Objektet e kultit lirohen nga pagesa, ndërsa objektet administrative dhe objektet përcjellëse fitimprurëse, faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-industrialë.”*

Në fund të diskutimeve, kryetari konstatoi se me 6 vota për dhe 2 abstenime, Raporti me amendamente për Projektligjin nr. 06/L-088 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit, dërgohet në komisionet e përhershme.

#### **Amendamenti 1**

Neni 4, paragrafi 2, riformulohet si në vijim:

2.Në nenin 20 të ligjit bazik, paragrafi 5, riformulohet me tekstin si në vijim:

***5. Objektet e kultit lirohen nga pagesa, ndërsa objektet administrative dhe objektet përcjellëse fitimprurëse, faturohen sipas tarifës për konsumatorë komercialë-industrialë.***

Për **Projektligjin për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja**, edhe pse më herët është formuar një grup i punës në përbërje: Salih Salihu, Ganimete Musliu, Etem Arifi dhe Muharrem Nitaj, kryetari **Nitaj**, propozoi që të gjithë anëtarët e komisionit të jenë pjesë e grupit të punës për shkak të rëndësisë që ka ky projektligj.

#### **4. Të ndryshme.**

**Besa Gaxherri**, propozoi që të shikohet buxheti për fushën e bujqësisë dhe mjedisit dhe ti jepet ndonjë propozim Komisionit për Buxhet, pasi që është koha e shqyrtimit të buxhetit për vitin 2019.

**Andin Hoti**, propozoi që për mbledhjen e radhës të ftohet ministri i MBPZHR-së dhe kryeshefi i Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, për të diskutuar për programin e granteve dhe subvencioneve për vitin 2019.

**Salih Salihu**, propozoi të bëhet një amendament për rritjen e buxhetit për dëmet nga fatkeqësitë në bujqësi, pasi që ministria ka pasur problem se nuk e ka nda me kohë buxhetin për këtë kategori. Gjithashtu, ai propozoi të diskutohen me ministrin e Bujqësisë në komision disa probleme të dëmtimit të fermerëve në dogana dhe në TVSH gjatë importit të makinave bujqësore. Për këtë paraqiti si shembull, rimorkion bujqësore që është shpërndarës i plehut dhe ata detyrohen të paguajnë TVSH dhe doganë edhe pse është makinë bujqësore, pastaj për laktofrizat për fermerët që prodhojnë qumësht dhe vetëm pse e ka emrin “friz” detyrohen të paguajnë doganë dhe TVSH.

**Salih Zyba**, së pari tha se nuk mund të pranojmë të përjashtojmë prezencën e ministrit për raportim në Komision, pasi që ai në takimin e fundit në komision ka thënë “*se jam i gatshëm që sa herë të kërkohet do të raportojë në komision*”. Pastaj shtroi disa kërkesa për raportim: të kërkohet raport për destinimin e mjeteve të Qeverisë për dëmet nga vërshimet, si dëme në bujqësi apo në amvisëri, pasi që kjo përmes buxhetit të Kryeministrit për disa komuna dhe janë disa ministri që e monitorojnë dhe ka dyshime për keqpërdorime të mjeteve. Të kërkohet raporti për gurëthyesit nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale dhe të ftohet në një diskutim në komision, sepse ka gurëthyes që veprojnë në vendbanime dhe në zona të mbrojtura, e që janë të ndaluara. Ndërsa, sa i përket Draftligjit për automjetet, pasi që sipas ministrit të MMPH-së në komision ka thënë se “*automjetet konsiderohen se janë ndotësi i dytë për nga rëndësia*”, atëherë ky draftligj duhet të kalojë edhe në Komisionin tonë.

**Muharrem Nitaj**, kryetar, në fund të mbledhjes, konstatoi se për mbledhjen e radhës do të ftohet në Komision, ministri i MBPZHR-së, bashkë me sekretarin dhe kryeshefin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë, për të diskutuar buxhetin e kësaj ministrie për vitin 2019.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40.

E përgatiti:

*Stafi mbështetës i Komisionit.*

Kryetari i Komisionit,  
**Muharrem Nitaj**